



Shkup, 14 korrik 2004

Deklaratë e përbashkët nga Përfaqësuesi i Posaçëm i BE-së, Soren Jessen-Petersen, Ambasadori i SHBA-së, Lawrence Butler, Kreu i Misionit Vëzhgues të OSBE-së, Ambasadori Carlos Pais dhe Brigadieri i NATO-s Dennis Blease

“Ne përzmërisht e mirëpresim marrëveshjen e arritur nga Qeveria lidhur me ligjet për Organizim Territorial dhe Qytetin e Shkupit.

Marrëveshja u arrit pas diskutimeve të gjata dhe intenzive nëmes partnerëve të koalicionit. Koalicioni multietnik qeveritar ka treguar aftësinë e vet dhe ka vënë në vend të parë interesin e shtetit dhe të qytetarëve gjatë arritjes së marrëveshjes nga e cila do të ketë dobi i tërë vendi.

Ne fuqimisht besojmë se marrëveshja paraqet një baraspeshë racionale nëpërmes të cilës respektohet plotësisht fryma dhe germa e Marrëveshjes Kornizë së Ohrit dhe se ajo do të forcojë demokracinë lokale në nivel komunal dhe se është në interes të ngushtë të të gjitha komuniteteve.

Marrëveshja e riafirmon zotimin e qeverisë për të qenë më afër strukturave Euro-Atlantike nëmes implementimit të plotë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe bashkësia ndërkombëtare mbetet e gatshme ta ndihmojë qeverinë me të gjitha mjetet e duhura për ta përshpejtuar këtë proces. Duke arritur pajtueshmëri, partnerët gjithashtu kanë konfirmuar edhe njëherë përkushtimin e tyre ndaj integritetit territorial dhe unitar si dhe karakterit multi-etnik të vendit, i cili patjetër duhet të ruhet dhe të pasqyrohet në jetën publike.

Aprovimi i ligjeve të decentralizimit para përfundimit të verës do të mundësojë mëtej që zgjedhjet lokale të mbahen ashtu si ishin të planifikuara për në tetor. Kjo do të lejojë përgatitje të pazvogëluar në implementimin e decentralizimit. Afatet kohore veçse janë ngushtuar dhe progresi duhet të vazhdojë të ecë përpara me shpejtësi më të madhe. Ne e presim me padurim angazhimin konstruktiv nga ana e partive në opozitë në dialogun e ardhëm. Ne gjithashtu presim që parlamenti të veprojë me sensin e duhur të urgjencës. Kjo është çështje vitale sepse çdo ngecje e mëtejme vetëmse do ta pengojë procesin në përparimin drejt intergrimit europian dhe prosperitetin e ardhëm të këtij vendi.

Procesi i decentralizimit është i rëndësishëm madhore në dhënien e shërbimeve publike të gjithë qytetarëve, për demokracinë e vërtetë dhe atë themelore lokale si dhe për reformën dhe europeanizimin e administratës publike. Ne e mirëpresim marrjen e një hapi guximtar dhe të patrembur nga ana e qeverisë, i cili plotësisht e mishëron frymën dhe germën e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit”.

-fund-

Pyetjet e shtypit duhet t'i drejtohen Sheena Thomson, këshilltare për medime dhe zëdhënëse në Zyrën e Përfaqësuesit Special të BE-së në Shkup, Tel +389 (2) 3222 089 dhe në celularin +389 (0) 70 358 03